

	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p align="center">PRISHTINA</p> 
---	---	---

Datë/a:	17.06.2022.
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: “ERIK” sh.p.k.
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Nexhmi Mekolli – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 15.06.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “ERIK” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe instituioneve tjera komunale”**, me Nr. të Prok: **616-22-82998-2-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “ERIK” sh.p.k. e parashtruar me datë: 15.06.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe instituioneve tjera komunale”**, me Nr. të Prok: **616-22-82998-2-1-1**, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues*, të datës **10.06.2022** të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe instituioneve tjera komunale”**, me Nr. të Prok: **616-22-82998-2-1-1**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues me datë: 10.06.2022 ka bërë publik Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në sistemin elektronik E-Prokurimi lidhur me rekomandimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull:

“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale”, me Nr. të Prok: 616-22-82998-2-1-1

Ju si Operator Ekonomik keni ushtruar të drejtën e juaj për Kërkesë për Rishqyrtim, pra me datë: 15.06.2022.

Pretendimet e juaja i keni paraqitur si në vijim:

Te pa kenaqur me njoftimin e datë 10.06.2022 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale me nr te prokurimit: 616-22-2998-2-1-1 Nr i brendshëm: 616 22 035 211 ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preeliminare e mosmarrëveshjeve, për këtë aktivitet të prokurimit ushtrojmë këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES:

A. ne mënyrë te kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate Operatorin Ekonomik qe nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK te vendosura ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë ka rekomanduar për kontrate një Operator i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te publikuara ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit (NJK dhe DT) te cilat po i cekim një nga një:

1.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontrate) ka qenë prej jo më pak se 1,400,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

OE i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotësuar keto kerkesa pasi qe ne njeren ane ne liste ka cekur se ka te realizuara kontrata Milioneshe ne Gjermani ndersa ne raporte financiare te

prezantuara nga vet operatori e tregojne te kunderten siç mund te shihet ne raportin e vitit 2020 ku ka operuar me humbje ne -44,170.90€ (minus).

Keto raporte nuk i kmei ne Original por vetem te perkthyer pra kjo na ben te dyshojme se vet OE i ka perpiluar dhe e ka cekur administrarta tatimore e mynih dhe eshte perkthyer por jo te leshuara nga adiministrata tatimore e munih.

2.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional:** Operatori e konomik duhet të ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata per sherbime te ngjashme ne tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate) minimum 1,000,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Ancksin 4 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve, kur sherbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërhen dëshmi e pranimit të shërbimeve si dhe transaksionet bankare.

OE ka dorezuar listen e kontratave por te gjitha kontratat qe i ka ne gjermani i ka me bleses privat andaj per keto kontrata nuk ja ka bashkangjitur dëshmin e pranimit te shërbimeve dhe transaksionet bankare, qe do te thote se nuk e ka plotesuar kete kerkese dhe eshte i pa pergjegjeshem.

3.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional** OE duhet te kete te punesuar gjithsej 40 punëtor prej tyre se paku paku 6 (gjashtë) punëtor qe kane certifikatë për mbrojtje fillestare nga zjarrit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kontratrat për marrëdhënie pune apo marrëveshje për angazhim ne pune, ndërsa për 6 punëtorët e certifikuar për mbrojtje nga zjarri duhet dëshmuar certifikatë nga një kompani e licencuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave

Lidhur me kete kerkese OE ka deshtuar qe ta plotesoj pasi qe nuk e ka plotesuar sipas

kerkeses se AK-se, jane kerkuar 40 punetore me kontrata dhe OE nuk i ka prezantuar ato kontrata qe do te thote se nuk e ka plotesuar edhe kete kerkese dhe eshte i pa pergjegjeshem.

4.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.**

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Një listë te pasijeve, sipas Aneksin 7, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për paisjet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marreveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorztoj edhe marreveshjen per shfrytëzim (te noterizuar).

Operatori i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar kete kerkese te AK-se pasi qe nuk i posedon asnjeren nga pajisjet e kerkuara nga AK, por OE e ka lajthit me qellim apo pa qellim AK-ne gjithashtu edhe AK eshte lajthitur me qellim apo pa qellim ku te gjitha marreveshjet e kontratat shihet nuk jane konform kerkesave dhe nuk i plotesojne kushtet per te u konsideruar te tilla.

Nese lexohen me kujdes marreveshjet qe i ka prezantuar OE i rekomanduar per kontrate nuk mund te quhen as kontrata te shiteblerjes e as kontrata te qirase pasi qe nuk i kane asnjeren element te ketyre kontratave dhe keto i kane vertetuar tek noteri sa per ilustrim po e permendim marreveshjen per furnizim me NTSH "Kujtesa" qe e perfaqeson Xhafer Shala ndersa tek nenshkrimi eshte emri Xhafer Gashi pra keto jane elemente qe na bejne te dyshojme se i kane krijuar vet ato marreveshje pa dijenin e Operatoreve me te cilet jane lidhe ato marreveshje. Pastaj marreveshja me AGRIBAU shpk ku palet merren vesh qe kompania Efa vetem me i pa ato pajisje dhe jo per diçka tjeter dhe e njejta eshte e noterizuar. Siq shijet kompania nuk ka asnje mjete pune ne pronesi te saj.

5.Operatori i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me çmime jo normalisht te uleta sa per ilustrim pozicioni nr. 16 lecka per pastrim micro fiber ka vendosur cmimin prej nje cent pastaj pozicioni numer 25 detergjent per pastrim lavamanav per gelqere 750 ml ka vendosur

çmimin prej nje cent. Pastaj pozicioni 31.

AK ka vepruar ne kundershkrim me nenin 61 te LPP-se, ne kundershkrim me nenin 42 te RRUOPP-se si dhe ne kundershkrim em formularin B57 te "Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulet".

Pasi qe nuk ka shanse te arsyetohet ekonomia e procesit te prodhimitarise (pika 2.1 e nenit 61 te LPP-se). Per pozicionet e cekura me larte.

Pra shihet qarte se ky OE eshte i pa pergjegjeshem

Oferta e Kompanise MSS

Mendojme qe edhe kompania tjeter pas kompanise se rekomanduar per kontrat nuk mund te quhet e pergjegjshme pasi ka ofertaur me nje çmim abnormalish te ulet.

Duke shikuar listat e çmimeve te dy keto kompani nuk mund te ja dalin te furnizojne me materiali hixhenik ti plotesojne kushtet dhe nevoja tjera te cilat jane te parapare ne dosjen e tenderit pasi ka mos perputhje mes çmimeve tr dhena ne oferte dhe çmimeve te tregut.

Autoriteti kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, ku AK ka vepruar ne kundershkrim me nenin 60 të LPP-së.

Besojme se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne kete aktivitet te Prokurimit andaj, Kerkojm nga AK qe ti rrespektoj ne perpikeri dispozitat e ligjit te prokurimit publik dhe te nxjerr;

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar kerkesa per rishqyrtim e Operatorit Ekonomik ERIK SH.P.K.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe instituzioneve tjera komunale** me nr te prokurimit: **616-22-2998-2-1-1** Nr i brendshëm: **616 22 035 211**. te inicuar nga Autoritetit Kontraktues **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**.

Baza ligjore për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

Pretendimi 1: Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Prokurimin Publik me Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ka kërkuar që Operatori/ët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi për qarkullimin e gjendjes financiare në vlerë prej: 1.400.000,00 €.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dërguar dëshmi se plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për përshtatshmërinë profesionale dhe gjendjen ekonomike pasi që në dokumentacionin e dorëzuar i tërë dokumentacioni është i përkthyer nga përkthyesi gjyqësor pra i licencuar me çka evitohet çdo paqartësi dhe dyshim për ndonjë parregullësi lidhur me qarkullimin financiar. Përkthyesi Gjyqësor bën përkthime të dokumenteve vetëm mbi bazën e prezantimit të dokumentit origjinal që është obligim ligjor dhe përgjegjësia bie mbi bazën e përkthyesit gjyqësor lidhur me prezantimin e dokumentit origjinal të përkthyer në gjuhën shqipe. Qarkullimi vjetor financiar mirret përbazë si tërësi në tri vitet e fundit e jo mbi bazën e asaj sesa ka humbje në qarkullim në një vit fiskal, andaj pretendimi ankimor është i pabazuar. Poashtu Autoriteti Kontraktues ka dorëzuar kërkesën për sqarim të tenderit me datë: 06.03.2022.

Pretendimi 2: Në bazë të nenit 69 par.2.1. të Ligjit për Prokurimin Publik me Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ka kërkuar që Operatori/ët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi për kontratat e realizuara dhe listën e kontratave të dëshmuara me referenca në vlerë prej: 1.000.000,00 €.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dërguar dëshmi se plotëson nenin 69 par.2.1. lidhur me dëshmitë për realizimin e kontratave me sektorin privat në bazë të sqarimit të dosjes së tenderit të dërguar nga AK me datë: 06.03.2022, ku iu është kërkuar decidivisht si në vijim: "Referencat ose certifikatat për kryerje të punëve, kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben dëshmi e pranimi të shërbimeve si dhe transaksionet bankare".

Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dërguar dëshmitë si në vijim: Referencat për kryerjen e shërbimeve të përkthyer poashtu nga Përkthyesi Gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi që konfirmon origjinalitetin e dokumentacionit.

Pretendimi 3: Në bazë të nenit 69 par.4.4.1,4.3. të Ligjit për Prokurimin Publik me Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ka kërkuar që Operatori/ët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë të angazhuar staf prej 40 punëtorëve me kontratë dhe së paku 6 punëtor të kenë certifikatë për mbrojtje fillestare

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur të gjitha dëshmitë dhe listën e stafit se posedon 50 punëtor me kontrata ku nga këta 50 punëtor 2(dy) prej tyre janë: Menaxher i Mirëmbajtjes dhe Ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjen nga zjarri dhe 6(gjashtë) të tjerë kanë kontratë dhe certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe gjithsej mbeten 42 punëtor higjienik.

Pretendimi 4: Në bazë të nenit 69 par.4.5. të Ligjit për Prokurimin Publik me Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ka kërkuar që Operatori/ët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë mjete dhe stabilimente.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur të gjitha dëshmitë me të cilat prezantohen të gjitha pajisjet dhe Kontrata është e lidhur me z. Xhafa Shala transaksionet e pagesave janë kryer në emër të shitësit Xhafer Shala dhe nuk qëndron fare pretendimi fiktiv ankimor dhe qëllimisht që ta vë në lajthitje AK. Të gjitha marrëveshjet e noterizuara janë obligim ligjor dhe përgjegjësi ligjore e noterit i cili noterizon dokumentin origjinal dhe i jep mbështetje dhe zbatueshmëri ligjore në bazë të paraqitjes së dokumentit të origjinal.

Pretendimi 5: Në bazë të nenit 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët të Ligjit për Prokurimin Publik me Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues ka analizuar ofertat e të gjithë operatorëve ekonomik ofertues dhe të gjithë kanë çmime të përcaktuara me çmimet e shërbimeve të tregut aktuar dhe si rezultat i kësaj operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës përmbush kriterin administrativ dhe analizën e çmimeve.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi
Arkivit

ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT

